

VENDIM
Nr. 763, datë 20.12.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1086, DATË 14.12.2013, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR PËRMIRËSIMIN E
NIVELIT TË ARKËTIMEVE DHE ULJEN E NIVELIT TË HUMBJEVE NË
SISTEMIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1086, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “c”, e pikës 5.1.1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Detyrat në lidhje me ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe marrëdhënia në raport me institucionet e tjera:

- Të raportojë në mënyrë periodike pranë këshillit mbikëqyrës të OSHEE sh.a. dhe ministrisë përgjegjëse për energjinë, rreth zbatimit të detyrave të caktuara;

- Të përgjigjet dhe të kryejë kontrole për çdo çështje të kërkuar nga këshilli mbikëqyrës i OSHEE sh.a. dhe ministri përgjegjës për energjinë;

- Të zbatojë detyrat që i ngarkohen nga Task-Forca, ministri përgjegjës për energjinë ose këshilli mbikëqyrës i OSHEE sh.a.;

- Të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse që disponojnë të dhëna për konsumatorët, me qëllim rakordimin e bazës së të dhënave (të tilla si QKB, ZVRPP, degët e tatim-taksave etj.).”.

2. Në pikën 6, fjalët “...deri më 31 dhjetor 2017...” zëvendësohen me “...deri më 31 dhjetor 2019...”.

3. Kudo në vendim, fjalët “... ministri i Energjisë dhe Industrisë ...” zëvendësohen me “... ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë...” dhe fjalët “...Ministria e Energjisë dhe Industrisë...” zëvendësohen me “...Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë...”.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Task-Forca dhe shoqëria OSHEE sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi